



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e dytë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal të Graçanicës

E mbajtur më datën 30.08.2024 në sallën e Kuvendit Komunal të Graçanicës dhe filloi me punë në orën 10:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje janë të pranishëm 11 nga 19 asamblistë dhe se ka kuorum, ndërsa mungojnë 8 asamblistë: Vlladica Qurçiq, Dragan Maksimoviq, Ljubisha Karaxhiq, Bojan ZHiviq, Zoran Danillovq, Jellena Dimitrijeviq, Snezhana Jovanoviq dhe Granit Gashi. Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, drejtori i Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, mediat (KIM), Shërbimi i Informimit dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit është mbajtur mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e ditës të caktuar për mbledhjen e sotme të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit tha se në bazë të nenit 44 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040) është caktuar rendi i mëposhtëm i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e rregullt, e mbajtur më datën 29.07.2024.
2. Informata për Qarkoren buxhetore 2025/02, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për ndërrimin e destinimit të parcelës kadastrale nr.9851/1 ZK Llapllasellë, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për fillimin e hartimit të Planit lokal të veprimit në mjedis (PLVM) për periudhën 2024-2029, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit për periudhën 01.12.2022-01.12.2023, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejiq.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e rregullt, e mbajtur më datën 29.07.2024.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 11 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Informata për Qarkoren buxhetore 2025/02, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se Qarkorja buxhetore 2025/02 është nxjerrë nga Ministria e Financave më 15 gusht 2024, ku shihet se buxheti për vitin 2025 është 9,753,348,00€ ose sipas kategorive ekonomike: paga dhe mëditje 4,513,068,00€, mallra dhe shërbimet 1,817,292,00 €, shërbime komunale 214,000,00 €, subvencione dhe transfere 410,859,00 € dhe shpenzime kapitale 2,798,129,00 € dhe këto janë kufijtë që duhet t'u përmbahemi.

Në mbledhje është i pranishëm asamblisti Granit Gashi, gjithsej 12 asamblistë janë të pranishëm dhe ka kuorum.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për ndërrimin e destinimit të parcelës kadastrale nr.9851/1 ZK Llapllasellë, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi tha se më 16 gusht kanë pranuar kërkesë nga Dioqeza e Rashkës e Prizrenit për ndryshimin e destinimit të tokës në Llapllasellë, e cila është në pronësi të saj, në mënyrë që në atë parcelë të ndërtojnë një kapellë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 12 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për fillimin e hartimit të Planit lokal të veprimit në mjedis (PLVM) për periudhën 2024-2029, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, tha se PLVM-ja e kaluar është miratuar nga Kuvendi për periudhën 2012-2017, andaj është e nevojshme që Kuvendi ta merr Vendimin për fillimin e hartimit të PLVM-së. Bartës i projektit të zhvillimit të planit do të jetë Shoqata "Rrjeti për Aktivizëm Qytetar", ndërsa qëllimi i zhvillimit të PLVM-së është identifikohen sfidat kryesore mjedisore dhe të propozohen masat për zgjidhjen e tyre. Pas hartimit të PLVM-së, dokumenti do t'i dorëzohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Asambletja Sllagjana Rashiq, para partisë “SRPSKA”, pyeti se kush është kryetar i Shoqatës “Rrjeti për Aktivizëm Qytetar” dhe çfarë u zgjidh me PLVM-në e kaluar sepse nuk u zgjidh problemi i djerrinës në Graçanicë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se problemi i djerrinës nuk është vetëm në kuadër të Komunës së Graçanicës dhe se problemi nuk do të zgjidhet me një plan të vetëm veprimi, por komuna duhet të ketë një dokument të tillë që të fillojë me zgjidhjen e atyre problemeve. Drejtoresha Gjekiq tha se aktualisht nuk e di se kush është kryetar i Shoqatës “Rrjeti për Aktivizëm Qytetar”, por asamblistët mund të dërgojnë pyetje në mënyrë që ajo t’u përgjigjet më vonë.

Kryesuesi shtoi se në një periudhë ka filluar gjelbërimi i djerrinës, por Trepça ka ndaluar hyrjen në të. U sugjerua që djerrina fillimisht të mbulohet me mbeturina ndërtimi (zhavorr) dhe më pas të hidhet dheu, megjithatë, Trepça refuzoi dhe në mandatin e fundit të Kuvendit, një OJQ nga Japonia doli për të spërkatur atë shtresë sipërfaqësore në mënyrë që të forcohet masa dhe parandalohet pluhuri, por Trepça e ndaloi edhe atë. Kohët e fundit ata kanë vozitur në djerrinë me kuadrate që ngrenë shumë pluhur dhe policia nuk po reagon fare.

Asambletja Sllagjana Rashiq, para partisë “SRPSKA”, tha se sipas disa hulumtimeve, të gjithë fëmijët që jetojnë pranë djerrinës kanë astmë.

Asambletja Sonja Odalloviq, para partisë “SRPSKA”, a është dhënë në shpjegimin e Trepçës arsyeja e refuzimit të bashkëpunimit.

Kryesuesi u përgjigj se komuna i ka dërguar vazhdimisht kërkesë Trepçës për zgjidhjen e çështjes së djerrinës dhe në sqarimin e tyre të fundit thuhet se bordi i tyre i drejtorëve duhet të ndryshohet.

Asambletja Dejan Jevtiq, para partisë “SRPSKA”, tha se Trepça nuk do të lejojë asnjëherë mbulimin e djerrinës, sepse në të ka një sasi të caktuar të pasurisë minerale.

Kryesuesi pyeti nëse në Shoqatën “Rrjeti për Aktivizëm Qytetar” ka ekspertë në kuptimin e ekologëve, etj.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se grupi punues që punon për hartimin e PLVM-së përbëhet nga punëtorë nga të gjitha drejtoritë e Komunës së Graçanicës, të cilët do t’i evidentojnë problemet dhe do t’i propozojnë zgjidhjen e tyre. Të dhënat për ndotjen e ajrit dhe lumenjve janë marrë nga Instituti në nivel qendror.

Asambletja Dushan Borisavljeviq, para partisë “SRPSKA”, tha se në periudhën paraprake kanë paraqitur peticion për çështjen e zgjidhjes së ndotjes së lumit Graçanka. Atëherë është lajmëruar prof. dr. e shkencës, Jellena Gjokiq, e cila ka marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve të tilla dhe ju duhet ta keni parasysh nëse duhet ta angazhoni.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se ata kanë bashkëpunuar me profesoreshën Jellena Gjokiq vitin e kaluar dhe këtë vit, e cila ka punuar në analizat e lumit Graçanka në Llapllasellë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 12 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit për periudhën 01.12.2022-01.12.2023, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejiq.

Drejtori i Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejiq, tha se përveç të gjitha aktiviteteve të rregullta, drejtoria i kryen edhe: pranimin dhe aprovimin e kërkesave (kryesisht për transport), mirëmbajtjen e kompleksit sportiv në Graçanicë, mirëmbajtjen e sallës sportive në Llapllasellë, kontrollimin e 32 terreneve stërvitore sportive në territorin e Komunës së Graçanicës, programe të ndryshme për edukimin dhe rekreacionin e të rinjve, sponsorizimet, organizimin e ngjarjeve sportive (festivale, gara, kampe sportive-rekreative dhe edukative për të rinj). Në vijim, drejtori foli për aktivitetet, projektet e realizuara dhe ndarjen e rekuizitave sportive të përmendura në raport. “Si sukses më të madh të punës sonë, ne e konsiderojmë ardhjen e Institutit Krahinor për Sport dhe Mjekësi Sportive nga Novi Sadi për t’i testuar aftësitë psiko-fizike dhe motorike si dhe ekzaminimet kardiologjike, testet laboratorike, ekzaminimet EKG dhe testet e baterive Euro-fit të fëmijëve dhe sportistëve tanë. Kemi mbajtur edhe një forum ekspertësh dhe në periudhën e ardhshme duhet të flasim më shumë me fëmijët për shëndetin dhe mënyrën e jetesës së tyre të shëndetshme, sepse sot në Serbi çdo i pesti fëmijë është i trashë dhe çdo i treti ka probleme me shtyllën kurrizore.

Asamblisti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, e vlerësoi punën e Drejtorisë për Rini dhe Sport, e cila ishte aktive në vitin 2023, siç tregohet nga raporti, ku janë renditur më shumë se 80 aktivitete.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 12 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.


Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Të ndryshme.


Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 10:38.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević